



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VI

Sesioni pranveror

Komisioni për Integritet Evropian
Mbledhja nr. 41
Prishtinë, më 20.03.2019 në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N- 302

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Blerta Deliu-Kodra, Armend Zemaj, Ismajl Kurteshi, Fatmire Kollçaku, Zenun Pajaziti, Visar Ymeri dhe Donika Kadaj-Bujupi.

Munguan: Fikrim Damka, Milaim Zeka dhe Adem Hoxha.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Ahtere Loxha, Adelina Demolli, Safet Beqiri dhe Florent Mehmeti.

I ftuar: Abelard Tahiri, ministër i Drejtësisë.

Mbledhjen e kryesoi; Blerta Deliu-Kodra, kryetare e komisionit.

Kryetarja e komisionit, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për punë, e hapi mbledhjen e komisionit me këtë

Rend Dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 04.03.2019 dhe 06.03.2019;**
- 3. Raportimi i z. Abelard Tahiri, ministër i Drejtësisë për zbatimin e Programit Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim- Asociimit (PKZMSA) dhe Agjendës për Reforma Evropiane (ERA);**
- 4. Të ndryshme.**

Kryetarja duke hapuri takimin e falënderoi ministrin për prezencën dhe kërkoi fillimisht të fillojë me raportimin, e pastaj të vazhdohet me pikat tjera për hir të respektimit të kohës së ministrit.

Rendi i ditës u miratua me këtë ndryshim:

Në vazhdim tha, siç e dini edhe ju, Ministria e Integritit Evropian ka filluar përgatitjen për Programin Kombëtar për Zbatimin e MSA-së për vitin 2019, si dhe për ERA -2.

Ndërsa, nga raporti final për zbatimin e PKZMSA-së për vitin 2018 të përgatitur nga Ministria e Integritit Evropian del se Ministria e Drejtësisë ka përbushur 65.79% të masave (25nga 38 masa të zbatuara).

Ne, si komision, ju kemi ftuar që të na raportoni lidhur me përbushjen e veprimeve nga ana e Ministrisë së Drejtësisë sa i përket PKZMSA për vitin 2018, si dhe ERA-së, në mënyrë që të shohim se cilat kanë qenë të arriturat dhe ngecjet në këtë drejtim dhe të mundohemi që me një bashkëpunim më të madh mes institucional të avancojmë rrugën tonë drejt përbushjes së obligimeve tona, pasi siç e dimë, varësisht nga përbushja e këtyre obligimeve kemi edhe avancimin e rrugës drejt integritit. Jemi të vetëdijshëm se sa i përket procesit të liberalizimit të vizave jemi në një fazë ku presim vendim-marrjen nga ana e shteteve anëtarë të BE-së pasi tashmë është e konfirmuar që institucionet tona i kanë përbushur të gjitha obligimet që ndërlidhen me këtë proces.

Mirëpo, sa i përket sundimit të rendit dhe ligjit, ne e dimë që përpjekjet dhe veprimet e institucioneve tona nuk duhet të përfundojnë me këtë proces, andaj edhe presim veprime të vazhdueshme nga ana e institucioneve përgjegjëse.

Në kuadër të procesit të integritit evropian nga takimi i nën komitetit për drejtësi, liri dhe siguri i mbajtur në vitin e kaluar kanë dalë disa konkluzione, ku në mesin e tyre kërkohet që të promovohet përdorimi i ndërmjetësimit të gjyqtarët, prokurorët dhe publiku, të vazhdohen përpjekjet për të futur Sistemin Elektronik të Menaxhimit të Rasteve në të gjitha gjykatat dhe prokuroritë sa më shpejt që të jetë e mundur, si dhe konkluzione të tjera.

Para disa ditëve patëm edhe publikimin e raportit nga Departamenti Amerikan i Shtetit mbi të drejtat e njeriut, në të cilin raport për Kosovën në mes të tjerash janë identifikuar korrupsioni, krimi i organizuar dhe performanca e dobët nga ana e institucioneve tona si dukuri më e theksuara.

Konsideroj se për kundër të arriturave ky raport do të duhet të na shërbejnë si alarm për të bërë akoma më shumë në luftimin e këtyre dukurive.

Prandaj, duke pas parasysh të gjitha këto zhvillime të cilat janë të ndërlidhura me ministrinë të cilën ju e udhëhiqni, Ju kemi ftuar që të na raportoni se cilat veprime keni ndërmarr me qëllim të përbushjes së këtyre obligimeve, si dhe cilat janë planet e juaja për këtë vit sa i përket përbushjes së obligimeve me qëllim të avancimit edhe të procesit të integritit?

Abelard Tahiri, ministër i Drejtësisë, tha se jam i nderuar që sot raportoj para jush për të arriturat dhe zhvillimet që ndërlidhen me PKZMSA-në dhe obligimet e ministrisë që unë drejtoj.

Ministria e drejtësisë ka arritur mbi 60% të implementimit të zbatimit të PKZMSA-së dhe kjo është mjaft inkurajuese, kemi pas një angazhim të madh, por një pjesë e këtyre nuk varen direkt nga MD, siç janë çështjet e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar. Sa i përket çështjeve që ndërlidhen me gjyqësorin, ka kaluar pakoja e ligjeve të gjyqësorit dhe një pjesë e obligimeve që kanë qenë të ndërlidhura me PKZMSA, këto ligje tani më veç kanë hyrë në fuqi dhe në kuadër të angazhimeve tona të përbashkët me KGJK-ën dhe KPK-ën jemi duke hartuar një plan të përbashkët veprimi, të cilin do ta arrijmë ta implemetojmë në periudha kohore në nxerrjen e udhëzimeve administrative, ndërtimin e mekanizmave të ri që parashihen obligimet tona që dalin prej këtyre ligjeve.

Lidhur me profesionet e lira, çështja e ndërmjetësimit, ligji për noterin ka kaluar, MD është në përrgaditje të akteve nënligjore, ta përdorim ndërmjetësimin si mundësi për ta lehtësuar punën e gjyqësorit dhe me ndryshimet e fundit që i kemi bërë në ligjin aktual do ta avancoj çështja e ndërmjetësimit.

Sa i përket noterëve, falë mbështetjes suaj që e keni dhënë, tani në Kosovë do të ketë një noter për 10.000 banorë. Kurse lidhur me çështjen e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar, jemi në pritje të nënshkrimit të dy marrëveshjeve me Malin e zi dhe me Italin, aty ku kemi hasur në ngecje është Instituti i Mjekësisë ligjore, vlen të theksohet se konkursi për zgjedhjen e drejtorit të këtij institucioni është përsërit disa herë dhe në herën e gjashtë është zgjedhur drejtori i ri dhe si rezultat te vonesës së zgjedhjes kemi hasur në vështërsi në implementimit të organogramit dhe nxerjes së rregulloreve te reja. Po ashtu edhe shërbimi korektues ka qenë sfid, por tani kemi një avancim duke e bërë riorganizimin në përputhje me praktikat dhe kërkesat e BE-së.

Një prej sfidave më të mëdha ka qenë qendra korektuese e Dubravës, sepse është e mbipopulluar, por kemi krijuar hapsira të reja ne qendën korektuese ne Prishtinë dhe kemi filluar transferimin gradual të personave që vuajnë dënimin një pjesë nga Dubrava dhe nga pjesët tjera.

Sa i përket agjendes për Reformën Evropiane, MD i ka pasur 3 obligime: Ligjinë për prokurorin e shtetit që ndërlidhet direktë me fuqizimin e prokuroris speciale, me rritjen e kapaciteteve të prokurorëve, pastaj Ligjin për parandalimin e konfliktit te interesit dhe Koncept dokumenti për suspendimin e zyrtarëve publik në rast të ngritjes së akatakuzës, dy prej tyre kanë përfunduar, kurse Koncept- dokumenti është përfshirë ne Kodin e procedurës penale që është dërguar për miratim në Kuvend. Vlen të theksohet se pas MPB, MD ka numër të madh të angazhimeve sa i përket zbatimit të MSA-së.

Tashmë kemi hyrë në një plan në implementimin e ligjeve të cilat i kemi miratu në Kuvendin e Kosovës. Kanë qenë trembëdhjetë projektligje, një pjesë të madhe të tyre, MD ka obligime mjaft të mëdha që lidhen me profesionet e lira, andaj pothuajse në masë shumë të madhe janë të lidhura edhe me PKZMSA dhe do ta kaloj 80% të implementimit.

Donika Kadaj-Bujupi: Unë i kam 2-3 tema të cilat mendoj se kërkojnë angazhimin tuaj. Lidhur me të drejtat e njeriut vazhdimisht është thanë edhe në raport të progresit, paraburgimet për gratë janë tepër të gjata, personalisht më kujtohen raste kur kanë qëndruar 3 a 4 vjet të paraburgosura, d.m.th. nuk i kanë dënuar as nuk i kanë liruar, kanë qëndruar të paraburgosura gra të cilat më së mas paku e kanë pasur vendin aty, sepse kanë pasur nevojë për trajtim tjetër në institucione tjera dhe jo në burg. Mirëpo në mungesë të përkrahjes nga shteti, në rend të parë pastaj edhe nga pamundësia që të ndihmohen nga familja, qoftë edhe me një avokat, ato kanë mbetur aty të harruara dhe janë raste shumë të rënda. Ushqimi është tepër i dobët dhe është tepër i shtrejtë nuk përmbanë as pemë as mundësi me pasur ushqime të freskëta, janë prodhime krejt jo cilësore të cilat ju shiten shumë shtrenjtë njerëzve të varfër. Sa herë e kemi ngritur këtë çështje aty me drejtorin, kanë thanë që po këtë herë ndodhi kështu, herën tjetër nuk do të ndodh. Do të duhen të sillen edhe frigorifer për me i ruajtur pemët, por as kjo nuk ndodh dhe besoj që kjo është një nga veprimet ku ju duheni konkretisht me veprua me u përmisua sa ma parë.

Është edhe një çështje tjetër bëhet fjalë për vizitat e shtetasve të huaj, sidomos nga Shqipëria sepse është një numër i madh i të burgosurave nga Shqipëria, ato përveç se ju vonohen seancat gjyqësore, familjarëve të tyre jua japin lejen vetëm 30 minuta vizitë,

është mundësia me ja u dhënë të paktën një orë me ligj, gjykatat asnjëherë nuk i shqyrtojnë specifikat por veç të njejtin shabllon e lëshojnë çdo herë për 30 minuta. Prandaj është kërkesë dhe unë nuk e kam thënë në seancë sepse nuk kam dashtë me bërë politikë, por mendoj që është momenti i fundit kur ju duheni me marr veprime konkrete me i përmirësu disa gjëra.

Ismet Beqiri: Brenga më e madhe e të gjithëve, jo vetëm në vend, po edhe atyre jashtë që na e dojnë të mirën është sundimi ligjit, luftimi i krimit të organizuar, korrupsioni, nepotizmit dhe unë nuk kam koment sepse sytë janë me pa çfarë po ndodh sidomos kohëve të fundit.

Në të gjitha institucionet publike unë e kuptoj që pushtetet janë të ndara, po megjithatë nuk mund të jetë kaq i ndarë pushteti, në këtë rast Ministria e Drejtësisë, bën përpjekje unë jam i bindur ose do duhet me bërë në drejtim të këtyre dukurive që janë shndëruar në dramë dhe besa janë pengesë madhe e jona për të shkuar aty ky synojmë. Të ju them sinqerisht nuk mundesh me u ndi mirë as si deputet, as si përfaqësues shtetëror, kudo që shkon, kur ballafaqohesh me pyetje ma të thjeshta dhe prej qytetarëve për këtë çka po ndodh, veçmas kohëve të fundit dhe tentimi me balancu se ky ka bërë keq, po bëj edhe unë, këto s'qëndrojnë fare.

E keqja është e keqe, cili do që e bën dhe vërtet është për me u shqetësuar, normalisht që e kem obligim të gjithë deputetët në këtë drejtim me dhënë kontributin pavarësisht pozitë dhe opozitë, ne po mundohemi edhe si opozitë me i krye ato obligime, veçmas në marrëveshjet e ndryshme ndërkombëtare që kanë të bëjnë me integrimin tonë në këtë rast edhe ato që kanë të bëjnë me fushën e drejtësisë, s'kemi qenë asnjëherë pengesë. Thënë thjesht, jashtëzakonisht jam i shqetësuar dhe i brengosur e besoj edhe shumica me atë çfarë po ndodh me institucionet tona me ndërmarrje tona publike, dhe sigurisht është jo vetëm përgjegjësi e juaja si ministër, por e gjithë qeverisë, e gjithë neve që në këtë drejtim me filluar me bërë përmirësime, në të kundërtën, nuk po mundemi më edhe s'kemi drejt me ju moralizuar njerëzve, me ju majtë ligjërat se si luftohet krimi, korrupsioni dhe nepotizmi. Unë po shprehi si shqetësim timin edhe besoj që e kanë edhe gjithë deputetët, sepse ne takohemi me njerëz dhe jemi në një situatë që jemi bë pengesë vet, pjestarë të institucioneve në rrugëtimin tonë të integritimeve.

Është e vërtetë që e kemi votuar Demarkacionin dhe janë bërë edhe do punë tjera, por po del që një problem më i madhi, pse tjerët s'po na dëshirojnë, ndoshta që është e padrejtë mos me pasur liberalizim vizash, është e padrejtë ndaj qytetarëve, por sigurisht me këtë shkallë enorme të krimit të organizuar dhe këtyre dukurive na duhet me pranë, nuk po na pranojnë, nuk na dojnë kështu si të tillë, me këto probleme nuk jemi të dëshirueshëm fatkeqësisht.

Ismajl Kurteshi: Ju folët për angazhimet tuaja në pregaditjen dhe aprovimin e disa ligjeve që në njëfarë forme, sipas matjeve tuaja i keni plotësuar 60% të obligimeve të ministrisë suaj karshi MSA-së, por në Kosovë problem kryesor nuk janë mungesa e ligjeve, është mungesa e respektimit të ligjeve dhe mungesa e Institucionit të përgjegjësive që në një farë forme bie barrë edhe mbi ministrinë tuaj, edhe pse ne e dimë që gjyqëësori është fajtori kryesor për këtë çështje. Po i përmendi disa vrejte të ekspertëve të huaj, që kanë bërë edhe në ligjet të cilat janë aprovuar. Në Korikun e vitit të kaluar 3 ekspertët Evropianë kanë pasur shumë vërejtje në Kodin e procedurës penale, po i përmendi vetëm disa, vërejtje shumë serioze ka qenë që sipas këtij ligji, departamenti i hetimeve të Policisë, ka të drejtë të vlerësojë vetë se a duhet me i mbyllur, apo duhet me i dërguar në prokurori rastet. Nëse policia vendos me i mbyll rastet, dihet se Policia nuk është gjyqësi dhe kjo është një shkelje e rëndë dhe mundësi

e jashtëzakonshme për korrupsion. Po ashtu vërejtje tjetër e të njejtëve është që prokurorët individual vendosin vetë pa raportuar dhe pa arsyetuar vendimin e tyre për mbylljen e rasteve, që po ashtu krijon mundësi të jashtëzakonshme për korruptime në prokurori. Vërejtje serioze ka qenë edhe mundësia e për shkrimin të lëndëve, edhe për shkak të numrit të madh të lëndëve edhe shpesh herë ndodh me qëllim, sidomos kur bëhet fjalë për njerëz me përgjigjësi të larta, që lëndët e tyre nuk trajtohen në kohën e paraparë me ligj dhe pastaj krime të rënda parashkruhen, që është shkelje e së drejtave të njeriut dhe mundësi që kriminelët të shpëtojnë pa u ndëshkuar. Po ashtu, ne e dimë që Ligji për konfiskimin e pasurisë ka kaluar, mirëpo ky ligj përkundër faktit që ka shumë të meta, e meta më e madhe është që deri tani nuk është regjistruar asnjë rast i konfiskimit të pasurisë të ndonjë zyrtari të mesëm, e lëre më të lartë, sepse këta të lartit edhe ashtu janë mbi ligjin, po as të mesëm nuk ka, përveç ndonjë të varfëri nëse kondiderojnë që ka diçka të paligjshme.

Ky ligj nuk vlen dhe ligjet në përgjithësi s'po vlejnë për ata të cilët janë vendim marrës dhe të cilët janë në pozita të larta në këtë vend dhe po hapet pastaj rruga që edhe disa zyrtar të rangut të dytë dhe të tretë të veprojnë njësoj, sepse në këtë vend nuk po përgjigjet askush për asgjë, përveç atyre që janë një kategori që vërtet nuk kanë asnjë lloj përkrahje në këtë shoqëri.

Meqë këto edhe shumë veprime të tjera kanë ndikuar edhe në liberalizimin e vizave, andaj çka keni ndërmarrë ju, si ministri, për përmirësimin e gjendjes në këtë fushë edhe pse pushtetet janë të ndara, mirëpo si ministri keni obligim që të ndikoni që gjyqësia të jetë më funksionale dhe ligjet të jenë edhe më të mira në mënyrë që të mbyllën të gjitha ato vrima përmes të cilave mund të kalojnë shkelësit e ligjit në situatë të ndryshme.

Ministri Abelard Tahiri: Çështja e paraburgimeve të gjata është çështje e gjyqësorit dhe në këtë rastë, ne, si MD, nuk kemi kurrfarë kompetence që mund të ndikojmë në zvoglimin ose rritjen e tyre, sepse kjo është ndërhyrje.

Sa i përket çështjes së trajtimit të grave në paraburgim, izolimi në çdo vend të botës është i rëndë, por nëse e krahasojmë rajonin, Republika e Kosovës ofron kushtet më të mira për qëndrimin e grave në qendrat korektuese. Sa i përket ushqimit dhe furnizimit me pemë dhe perime që e përmendët, kemi një angazhim jashtëzakonisht të madhë që të plotësohen gjitha nevojat dhe në anën tjetër, po ashtu egziston edhe një kantinë, e cila fatkeqësisht ligjet e prokurimit mundësojnë me i zhvilluar këto procedura që i kemi realisht dhe vazhdon me qenë një sfidë e madhe çështja e ushqimit nëpër burgje. Prej momentit që e kam marrë mandatin si ministër i Drejtësisë jam ballafaquar me mungesa të ndryshme si rezultat i vazhdimin dhe stër vazhdimin të procedurave të prokurimeve publike, kthimit nga OSHP-ja me shkallë të dytë, të tretë e kështu me radhë. Tani jemi në një periudhë ku drejtori i sigurisë, a me menduar për sigurinë në burgje, a me menduar për ushqimin. Ne në një projekt së bashku me Ambasaden Amerikane jemi duke punuar si me adresuar në të ardhmën çështjen e kantineve dhe ushqimit të cilat të burgosurat edhe të burgosurit në Kosovë ushqehen gjatë periudhës sa e kalojnë në këto qendra korektuese. Një pjesë të çështjes së vizitave që ju e përmendët dhe kalimit të vikendeve që i kanë, i kemi adresuar në Ligjin për ekzekutimin e sanksioneve penale, ju e dini që në ligjeshaturën e kaluar është miratuar një ligj, ku është zvogëluar numri i vizitave dhe i shfrytëzimit të ditëve të vikendit. Tashmë e kemi ndryshuar dhe e kemi kthye, siç ka qenë më herët, sepse mendoj ka qenë e padrejtë zvoglimi i ditëve të vikendit, pushimit për këta persona që e vuajnë dënimin në qendrat korektuese, shpresoj që do ta kemi përkrahjen tuaj që edhe kjo dispozitë ligjore të kalojë.

Donika Kadaj-Bujupi: u ndërlidh ne diskutim dhe tha, së pari ministër nuk prita që e relativizoni deri në këtë shkallë, duhet pas ma shumë ndjeshmëri shteti në raport me ata të cilët e vuajnë dënimin, jo me tentuar me i dënua edhe njëherë ata mbrenda që po e vuajn dënimin e tyre

E dyta nuk është ndërhyrje nga ana e shtetit me e trajtuar çështjen e shkeljes së drejtave të njeriut dhe shkeljes flagrante të ligjit vit pas viti.

Në Raportin e progresit, është thënë që paraburgimet e gjata përbëjnë shkelje flagrante të ligjit, dhe normal që shteti duhet me ndërhye me kërkuaar çka po ndodh. Unë nuk po pyes, pse një grua është dënuaar 20 vjet, sepse atëherë kishte me qenë ndërhyrje në vendimin e gjykatës, por pse një grua është mbajtur 4 vjet në paraburgim aty, duhet edhe ministri edhe Kuvendi, të gjithë me u marrë me atë temë, se nuk është ndërhyrje nëse gjykata i shkel të drejtat e njeriut, prandaj janë instancat apo jo! E dyta nuk është bash me relativizu punën e shëndetit të tyre sepse siç e thashë ato e vuajn dënimin për veprën e kryer, por kjo nuk do të thotë që duhen aty me vuajt edhe në kuptimin me i torturuaar sepse dikush e bën një tender e don me keqpërdor, edhe tash me u paguar gjithë ai dëm te ata që janë brenda apo jo. Domethanë në “OSHP” deri sa shkon 10 herë ata njerëz vuajn brenda sepse mungojnë edhe ushqimet esenciale, edhe kjo duhet edhe njëherë me u ritraju prej ministrisë veprimet e shtetit dhe përkujdesja e shtetit në raport me kategoritë e marginalizuara, në këtë rast që janë në pa mundësi që të mbrojnë të drejtat e tyre sepse janë të izoluaar, duhet shteti me ju mbrojtë të drejtat, domethanë nuk është fort për me relativizu këtë çështje. Po më vjen mirë që e keni trajtuaar në këtë ligj çështjen e shtetasve të huaj, mirëpo mendoj se disa veprime të cilat veç se janë të përcaktuara në ligjet tona, duhet veç me u zbatuaar edhe me e pas një ndjeshmëri dhe vullnet me i zgjidhur, se nuk po më doket që është ndonjë problem shumë i madh 2 a 3 aspekte që lidhen drejtëpërsëdrejti me të drejtat e tyre me i trajtuaar ma seriozisht.

Ministri: Pikërisht këto që lidhen me të drejtat e paraburgosurve, ne i kemi adresu në Ligjin për egzekutimin e sanksioneve penale. Sa i përket çështjes së ushqimit dhe të qëndrimeve të paraburgosurëve, pa dyshim kjo është pjesë e përditëshmërisë time si ministër i Drejtësisë të cilën e trajtoj për të gjithë të privuaarit nga liria në qendrat korektuese në Republikën e Kosovës. Mirëpo nuk kam mundur me rregullaar brenda një viti, kjo është çështje që po e rregulloj brenda vitit 2019 dhe tash po e bëjmë rikategorizimin edhe njëherë të atyre të cilët janë të privuaar nga liria dhe jemi duke i adresuuar. Sa i përket stërgjajes së procedurave, mendoj se Draft- Kodi i ri i procedurës penale do t'i qartëson edhe më shumë këto çështje, besoj që sapo të miratohet Ligji për rregullimin e sanksioneve penale dhe Projekt-kkodi i procedurës penale mendoj që do të jenë shumë më të qarta edhe për gjyqtarët edhe për prokurorët. Sa i përket çështjes te keqpërdorimet të punës publike, nepotizmi e kështu me radhë, unë fatkeqësisht dje e kam pasur një prezantim, para gjithë shefave të misioneve të Bashkimit Evropian, janë 22 shefa të misioneve, si ministër i Drejtësisë mbi zhvillimin në fushën e sundimit të ligjit. Fatkeqësisht në periudhën e fundit nuk kemi dërguaar mesazhe të mira vendeve të Bashkimit Evropian mbi punën në institucionet tona, si ministër i Drejtësisë jam mundaar me dhënë shembullimin më të mirë, sidomos në rekrutimin e pozitive të larta politike, kanë qenë 4 pozita të cilat janë emëruaar në përputhje me projektin e Ambasadës Britanike, pra jam mundaar me adresuare drejtë si çështje.

Kemi pasur konkursin për shërbimin korektues, ku janë pranuaar 120 të rinjë deri në moshën 33 vjeçare, kam kërkuaar që në përpikmëri mu rekrutuaa njerëz të cilët e meritojnë me qenë në Shërbimin korektues të Kosovës.

Sa i përket çështjes që e ngriti zotri Kurteshi, të 3 ekspertëve që kanë qëndruaar gjatë korikut të vitit 2017, në Republikën e Kosovës, çështjet të cilat i kandë adresuare ata

rreth hetimeve i kam adresua dhe kjo çështje është tejkalu, pra është prokurori ai i cili vendos për mbylljen e hetimeve nga polici, e jo polici. Edhe sa i përket çështjes së prokurorit nëse ai ka të drejtë t'i mbyllë hetimet, po ashtu pala që inicon këto hetime ka të drejtë ankese në shkallën e dytë, pra nuk është çështje siç ka qenë në të kaluarën, pra mos të jetë prokurori ai i cili do të vendos të mbyllet rasti apo jo, mirëpo t'i jep edhe një shansë palës e cila ka inicuar këto hetime që t'i ofrojë argumentat e veta në shkallën e dytë karshi provave që janë mbledhur. Sa i përket çështjes së konfiskimit të pasurisë, mendoj që ka qenë pika më e dobët si institucione nga paslufta. Kemi pasur një ligj në fuqi deri tash shumë të pa favorshëm për Institucionet tona, mendoj tani çështja e barrës së provës është rregulluar dhe tani e kemi një sistem proporcional i cili e mbron po ashtu edhe pavarësinë dhe sigurinë juridike të qytetarëve dhe i jep prokurorëve dhe hetuesve mundësi shtesë për hetimin dhe konfiskimin e pasurisë së titulluar vepër penale, pra kemi një kalim të barës së provës nga prokurori tek i dyshuari që më herët nuk ka qenë. Ne në bashkëpunim me ekspertët e BE të cilët kanë punuar me ne në draftimin e Kodit të procedurës penale, Ligjin për konfiskimin e pasurisë i kam adresua konform edhe kërkesave të tyre dhe me standardet të BE-së, gjithmonë duke e mos cenuar sigurinë juridike të qytetarëve. Lidhur me adresimin e pa përgjegjësisë së prokurorëve, dhe gjyqtarëve ku ata abuzojnë me punën e tyre dhe i tejkalojnë kompetencat e tyre tha, deri tash e kemi pasur Zyrën e prokurorit diciplinor, që ka qenë shumë jo efektive, jo për shkak të vullnetit të atyre njerëzve, mirëpo për shkak të strukturës se si ka qenë e rregulluar kjo zyre.

Me mbështetjen e juaj ne e kemi arritur tashmë këtë përgjegjësi me vendos në Këshillin gjyqësor dhe në Këshillin prokurorial dhe përgjegjësia fillon nga kryetari i Gjykatës Themelore, ose kryeprokurori i Prokurorisë Themelore dhe shkon deri te kryetari i Gjykatës Supreme. Pra, përgjegjësia ju bie direkt atyre dhe ne do të kërkojmë llogari nga ata, atëherë ku shohim se ka papërgjegjësi, ka shkelje siç e përmendi edhe znj. Kadaj çështjen tejkalimit të kompetencave të tyre, zgjatjen e paraburgimeve e kështu me radhë, pra sot e kemi një mundësi.

Sot e kemi edhe Avokatin e Popullit i cili e ka një instrument ligjor në dorën e tij që derivon prej këtij ligji, pra ka mundësi me kërku fillimin e një procedure të hetimit ndaj një gjyqtari ose prokurori që më herët nuk ka qenë për punën ose për abuzimin e tij. Pra janë krijuar instanca që shpresoj që nuk do të kemi pengesa në zbatimin e këtyre ligjeve dhe jam duke e shtyer maksimalisht me përgjegjësi dhe kapacitetin tim si ministër i Drejtësisë në implementimin e tyre në krijimin e këtyre mekanizmave, dhe të shohim masa konkrete, sepse ne shohim që çalojmë në zbatueshmërinë e ligjit domethanë kjo është e evidente, ne çalojmë si shtet në zbatueshmërinë e ligjeve, pra përpjekja ime është që këto ndryshime që i kemi marrë pikërisht me i adresua. Me këtë pako të ligjeve kemi adresuar një pjesë të madhe të këtyre të metave të sistemit tonë, pra mendoj që është e rregulluar.

Sa i përket sinjalizuesve ne në rajon mendoj që jemi të parët që e kemi trajtu jashtëzakonisht mirë çështjen e sinjalizimit. Une e kuptoj tash ai sa ka hyrë në fuqi, ende nuk është e qartë, as për zyrtarët e institucioneve cilat janë përgjegjësitë e tyre dhe do të ndërmarrë një fushatë sensibilizuese ta bëjë të qartë rolin e sinjalizuesit se sa i rëndësishëm është në denoncimin e keqpërdorimit edhe në kompani publike, dhe në kompani private por sidomos në kompani publike, në institucionet të cilët menaxhojnë taksat e qytetarëve të Kosovës. Pra do të vazhdojë me agjendën time në implementim të këtyre ligjeve, në krijimin e këtyre mekanizmave, të cilat do t'i adresojnë përgjegjësitë dhe lëshimet të cilat i kemi pas në të kaluarën.

Armend Zemaj: Ne z. ministër kemi nevojë për masa adekuatë konkrete, se me fasada edhe ne edhe qytetarët e Kosovës janë ngopur, rezultatet janë shumë jo frytëdhënëse, qoftë edhe ndryshimet legjislative dhe plotësimin e masave që ju i përmendët si pjesë e përbushjes së agjendës Evropiane, po qoftë edhe pjesa tjetër që lidhet me zbatimin e MSA-së.

Ne e kemi pasur një vlerësim të kapaciteteve të sistemit të drejtësisë në luftimin e krimit të organizuar dhe korupsionit, kjo po duket më shumë sesa e vërtetë, edhe pse e kemi pasur një debat nga ai raport që është konsideruar i pavarur nga disa përfaqësues të Komisionit Evropian, e kemi ballafaquar këtu edhe me juve edhe në debat publik dhe Ministrën e Integriteteve Evropiane, por kur është përkthyer në shifra dhe rezultate tregon që ai ka qenë shumë real, pse po e them shumë real, se nëse i marrim edhe statistikat e vitit 2017-2018 e shohim se sa janë rritur veprat penale në Republikën e Kosovës, vjedhje grabitja vrasje, aksidente në trafik korupsion, mos zbatim të ligjit, afera të nepotizmit e shumë e shumë gjëra të tjera. Të gjitha këto e kanë bërë që Kosova përkundër përbushjes së kriterëve për liberalizim të vizave, mos ta marrë dritën jeshile që qytetarët tanë të lëvizin lirshëm dhe kjo është bregja jonë e përgjithshme dhe kjo duhet të jetë fokusi primar. Fokusi tjetër është në aspektin e brendshëm të miratimit të ligjit, por mos zbatimit të tyre apo mbiqyrjes zbatuese dhe raporti juaj me institucionet tjera të sigurisë dhe drejtësisë në vend. Personalisht më intereson raporti juaj me Këshillin Gjyqësor dhe Këshillin Prokurorial nga aspekti edhe institucional, sepse hallka zingjirë e funksionimit të sistemit të drejtësisë në vend duket se është çakorduar totalisht në funksionimin e saj efektiv. Është shqetësuese sepse pa siguria juridike që ekziston sot në Kosovë i prek të gjithë pa dallim, por njerëzit e fortë që qëndrojnë mbi pushtetin e mbi ligjin janë duke shrytëzuar këtë situatë edhe janë duke arsyetuar me shembuj shumë banal që nuk përkojnë me etikën institucionale, po as morale të funksionimit të një shteti demokratik edhe ligjor.

Ju, si ministri e Drejtësisë, në këtë fazë mendoj që do duhet të kishit ndonjë përgjigje për 4 pika; Së pari për Ligjin për sinjalizuesit, mendoj që ju duhet të na tregoni cili është kordinimi ndër institucional në këtë pjesë, sa ka arritur Ministria e Drejtësisë që me gjitha institucionet tjera ta vëj në dinamik tjetër ligjin për sinjalizuesit, ta mbrojë ligjërisht dhe kjo sigurisht e ndihmon luftimin, ndjekjen dhe gjykimin e krimit të organizuar dhe korupsionit në vend.

E dyta është noteria, funksionimi i sistemit të prokurorisë para miratimit të ligjit, sepse e dini që kemi pasur një stërgjatje të miratimit të ligjit në Kuvend të Kosovës dhe pas dhe mungesa e noterëve por edhe funksionimi i saj.

E treta, janë përmbauesit privat. Përmbarimi privat në Republikën e Kosovës është shëndëruar në një mekanizëm për t'i dëmtuar njerëzit e varfër, jo ata që nuk paguajnë obligimet financiare që i kanë dhe të cilët janë të lidhur direkt me këtë sistemin paraprak që e përmenda, i cili është në funksionin e policisë apo edhe gjyqësisë.

Besoj që MD duhet ta ketë në fokus të qartë, ne, si deputetë të Kuvendit të Kosovës marrim ankesa kur njerëzit potencialisht që jetojnë në skema sociale bëhen pre e përmbauesëve pa ndonjë arsyetim efikas, nuk do të thotë që unë nuk jam për ligjin të vlej, por nëse shihet raporti se si funksionon në raport me struktura tjera kjo tregon që aty është një çëllim i cili mund të vihet në shprehje për shkak të pa fuqisë së tyre dhe kemi pas shembuj edhe familje që pa dashtë me prek pjesën sensitive, qoftë familje që jetojnë në skemën sociale, qoftë familje të dëshmorëve ose femra që janë bartëse të përgjegjësisë së mbajtjes së fëmijëve të mitrurave dhe jetim e tjerë.

Pjesa e katërt është Konfiskimi i pasurisë së pa justifikueshme në Republikën e Kosovës është dështim total, edhe ajo pasuri e cila është për momentim thuhet që është konfiskuar iu është kthyer trafikantëve, sidomos trafikantëve të drogës dhe pjesë tjera

që ndërlihen me krimin e organizuar dhe korrupsionin, por të mirat e tyre të grabitura në këtë form fare nuk u janë kthye qytetarëve dhe as shtetit dhe nuk janë pjesë e buxhetit të Republikës së Kosovës.

Të gjitha këto që ju i potencuat faktikisht që kanë qenë dy vitet e fundit, ndryshimet legjislative, unë besoj dhe nuk do të duhej të ishin përdorim i Ministrisë së Drejtësisë, si fasadë atë që e përmenda, për të mbuluar rritjen e krimit të organizuar, korrupsionit dhe veprave delikuede që po ndodhin në Republikën e Kosovës, kjo tregon edhe anën tjetër të medaljes, atë që është reale. Unë i kam marrë statistikat e policisë, gjyqësorit, prokurorisë ,të vitit 2017-2018 dhe shikoni sa është në rritje numri i veprave penale në Republikën e Kosovës. I kam marrë edhe statistikat e nga Enti i statistikave i përfudnimit të vendimeve gjyqësore ju mund ta analizoni e shihni. Te veprat penale, shumë dallon në raport me atë çka presin qytetarë e vendit dhe sigurisht edhe ju si Ministri e Drejtësisë. Ne kemi problem të madh, me 2 trupat, Këshillin Gjyqësor dhe Këshillin Prokurorial, nuk e di qysh e keni paraparë ta avansoni këtë fushë, dilemat kanë dalë edhe tash në zgjedhjet e reja që kanë ndodhur brenda këtyre trupave, ndërhyrjet politike, mos profesionalizmi, mos përcjellja e performancës së gjyqtarëve dhe prokuroërve dhe çdo gjë që ju mund ta bëni edhe e bën Kuvendi i Kosovës në raport me avansimin legjislativ, nëse nuk ka vullnet dhe nëse nuk ka mos ta quaj guxim, po guxim profesional për ta implementuar dhe për të luftuar dukuritë negative në vend, ne do të rikthehemi aty ku na ka qitur raporti i këtyre 3 ekspertëve të Komisionit të Evropian që e kanë dhënë për vlerësimin e kapaciteteve të drejtësisë. Unë nuk dua ta shoh as vendim tim, asnjë ministri, sidomos me këto ministri që kanë të bëjnë me sistemin e sigurisë në vend në aspektin negativ dhe të përballjes çdoherë me kritika. Ajo çka më vjen mirë është që unë e kam ndëgjuar edhe deklaratë e fundit që ju e keni potencuar që Kosova po vuan prej krimit të organizuar dhe korrupsionit, është diçka që nuk e keni fshehur as ju si ministër i Drejtësisë dhe besoj që kjo duhet të jetë në maksimumin e luftimit të saj dhe të eliminimit nëse dëshirojm që të kemi shtet të fuqishëm mbi të gjitha rrugëtim Evropian dhe marrjen e liberalizimit të vizave.

Visar Ymeri: Mendoj që veçnisht në sistemin e Drejtësisë duhet ta kemi një kreativitet dhe autenticitet vendor, sepse drejtësia dhe demokracia janë dy rregullime shoqërore dhe shtetërore të cilat nuk mund të importohen, pra nuk mund dikush të vijë dhe të na krijojë një sistem të drejtësisë ashtu çfarë kemi nevoj ne, nëse ne nuk e kemi as vullnetin e as kapacitetin për ta bërë një gjë të tillë për së brendshmi. Natyrisht që po ta themi kështu në mënyrë të përgjithësuar, po besoj që të gjithë pajtohemi që neve na duhet një drejtësi e cila funksionon për të gjithë në mënyrë që të shpërndajë barazi para ligjit për të gjithë qytetarët dhe të funksionoj sipas parimeve univerzale. Unë mendoj që në këtë drejtim është MD që duhet që t'i mbrojë këto parime univerzale të drejtësisë të cilat aplikohen në vend dhe t'i avansojë, ta ketë kreativitetin e duhur në mënyrë që të sigurohen që parimet bazë dhe univerzale të drejtësisë po zbatohen në vendin tonë.

Vazhdimisht çfarë kemi dëgjuar nga ekzekutivi janë dy gjëra, pra në njërin anë pavarësia e sistemit të gjyqësorit që është thelbi i një sistemi të drejtësisë në vend dhe në anën tjetër gjendja e keqe në të cilën ose starti i keq të cilin e kemi pas dhe pastaj pamundësia e avansimit jashtëzakonisht të madh të saj.

Mirëpo vazhdimisht këtu jemi përballur me një lloj varësie nga jashtë për sa i përket kësaj çështje pra vazhdimisht saherë që kemi diskutuar për sistemin e drejtësisë, ne kemi diskutuar për përqindjen statistikore të zbatimit të masave të cilat janë pak a shumë të dizajnuara nga BE.

Në këtë drejtim mendoj që duhet ta bëjmë një ndarje në mes të parimeve univerzale dhe mekanizmave zbatues të cilat duhet të jenë vendore dhe lokale, sepse duhet t'i përshtaten aktualitetit tonë ekonomik e kulturor në mënyrë që ato të kenë sukses.

Kjo natyrisht pastaj lidhet drejtë për së drejti me vullnetin e mirë që duhet ta kenë veçanërisht njerëzit që janë në ekzekutiv për sa i përket sistemit të drejtësisë.

Pra, një pyetje kështu e përgjithshme është që a duam ne të ndërtojm një sistem i cili ndëshkon e që është goxha sistem i mesjetës, apo sistem që risocializon e që është sistem modern demokratik.

Pra, tash sa herë flasim ne për burgje në njëfarë mënyre i konsiderojm njerëzit e burgosur sikur të ndëshkuar, ata normalisht e vuajnë një dënim që ju ka caktua gjykata, mirëpo në anën tjetër, unë mendoj se sa i përket kësaj çështje obligimi parësor i ministrisë duhet të jenë programet e ri socializimit, të cilat ua mundësojnë njerëzve që kur dalin nga burgjet ta kenë mundësinë që të ri socializohen pra të përshtaten në shoqëri e të mos shtyhen nga sistemi i drejtësisë në përsëritjen e krimeve dhe veprave të cilat i kanë dërguar ata në burg.

Kur flasim për ndarjen e pushteteve edhe për pavarësinë e gjyqësorit, po gjyqësori duhet të jetë i pa varur në vendimet e veta, por kjo nuk nënkupton që gjykatësit ose prokurorët individualisht duhet ta trajtojnë atë si pronë private dhe të marrin çfarëdo vendimi që atyre ju a merr mendja dhe të mos kenë kurrfarë mekanizmi përcjelljes të punës së tyre edhe ndëshkimi kur ka nevojë. P.sh. ne kemi pas raste të dënimit të njerëzve pa kurrfarë fakti, siç është rasti për 5 aktivistët e Lëvizjes Vetëvendosje, kemi pas edhe raste të vdekjes në burg, siç ka qenë rasti i Astrit Deharit dhe për këto duhet dikush të marrë përgjegjësi.

Jo gjykatësi nuk ka të drejtë me dënua dikend pa kurrfarë fakti, nuk mund të jetë ai mendim i lirë i gjykatësit, gjykatësi e ka obligim me interpretu ligjin, por interpretimi i ligjit nuk mund të jetë e kundërta e tij. Kështu që në këtë drejtim ne nuk duhet me rrëshqit në gabimin e ndërtimit të një sistemi të dynjësuar, i cili mban edhe parimet e gjyqësisë anglo-saksone edhe pastaj të gjyqësisë kontinentale që është njeri prej probleme që e kemi në Kosovë. Kemi një konfuzion goxha të madh edhe në mënyrën se si janë shkruar ligjet dhe si implementohen ato dhe mendoj që po ashtu është përgjegjësi ose do tu duhej të ishte përgjegjësi e MD, që ta bëj një revizion të të gjitha ligjeve të paketës sonë legislative në mënyrë që ta bëjmë përshtatjen e tyre që të funksionojn ato njëra me tjetrën përbrenda një mekanizmi. Në raport me sistemin e gjyqësorit, jo vetëm me sistemin e gjyqësorit, por veçanërisht aty, mendoj që është e domosdoshme që ta kemi një proces të mirëfillt të Vetëingut i cili nuk e trajton vetëm pasurinë e gjykatësve, prokurorve e të tjerëve, por e trajton edhe kapacitetin profesional të tyre. Pra, a kemi ne si shtet të paktën një mekanizëm që e përcjellë punën e gjykatësve individual dhe e sheh sa raste prej tyre i kanë trajtuar sa nuk i kanë trajtuar me çëllim, sa i kanë trajtuar dhe e kanë keq interpretuar ligjin e kështu me radhë. Sepse mendoj që pa i pas këto, pa e pas një vlerësim të këtillë, nuk mund të flasim për përmirësimin e gjyqësorit, pavarësisht se çfarë ligje bëjmë, sepse ligjet edhe nëse janë shumë të mira, por nëse ato nuk zbatohen ose keq interpretohen edhe ligji i mirë pastaj bëhet i keq dhe bëhet i dëmshëm. Në këtë drejtim konsideroj që, një prej shkeljeve ma të mëdha të të drejtave të njeriut që ndodh në Republikën e Kosovës janë pikërisht nga sistemi i gjyqësorit dhe mendoj që një prej arsyeve që të zhgenjimit të qytetarëve për sa i përket perspektivës në Kosovë është edhe gjyqësori, sepse me kalimin e kohës qytetarët kanë filluar ta kenë një përshtypje dhe ato natyrisht që e kanë të bazuar, se drejtësia në Kosovë nuk është e barabartë për secilin dhe rrjedhimisht nëse drejtësia nuk është e barabartë për secilin dhe në anën tjetër ekonomia nuk prodhon trajtim të barabartë në shoqëri atëherë kjo është mungesë absolute e prespektivës për të jetuar në

Kosovë, rrjedhimisht vendime për me dalë jashtë edhe me gjetë një jetë ma të mirë jashtë.

Pra, si përfundim unë e kuptoj natyrisht që secili ministër që vjen të raportoj në komisionet e Kuvendit të Republikës e paraqet punën e vet edhe si të them kështu sukseset në punën e vet dhe kjo nuk po them që nuk është e vërtetë ose këtu që i keni paraqitur ju këtu janë të përmbushura. Mirëpo nuk duhet me rrëshqitur po ashtu në një gabim të shkëputjes komplet në mes të asaj që thuhet institucionalisht në realitetin që e kemi në terren, pra nëse ne e kemi një realitet të këtill në terren ku secili që flet për sistemin e drejtësisë thotë që e kemi një problem jashtëzakonisht të madh, krimi, korupsioni mos ndjekja e tij, rritja e veprave penale dhe në anën tjetër flasim për sukseset edhe përmbushjet e 60% të masave të cilat janë caktuar nga MSA- ja, edhe pse kjo është e vërtetë, prap mendoj që e tregon një mos ndjesi karshi asaj çfarë është duke ndodhur.

Mendoj që duhet ta trajtojmë problemin në thelb të tij, pra unë besoj që ne këtu nuk kemi dhe nuk do të duhej të kemi mospajtim për fakte, nëse dalim në këtë fushë të mos pajtimin të fakteve atëherë është problem se s'mund të debatojmë, por kur pajtohemi për fakte atëherë edhe debatojmë se cila kishte me qenë rruga më e mirë për me gjetur zgjidhje, por nëse ne, si deputetë, themi që gjendja është keq dhe ju nga ekzekutivi thoni që është shumë mirë, bile jemi ma së miri në rajon atëherë kemi mos pajtim për faktet, atëherë ne s' kemi çka me folur për tjetër gjë.

Fatmire Kollçaku: Nëse kjo Qeveri mbijeton këtë vit, besoj se ju si ministri do ta keni sfidën më të madhe, pikërisht tash zbatimin e legjislacionit. Deri tani ne mund të themi që 20 vite jemi marrë, qoftë me miratimin e ligjeve, qoftë plotësim ndryshimin dhe e kemi pa si arsye që nuk po e kemi krejt legjislacionin e kompletuar me arritur mi luftuar të gjitha këto sfida për të cilat u fol.

Ju, ministër, e dini që sfida më e madhe dhe kushti i vetëm i liberalizimit të vizave apo sipas prespektivës Evropiane është luftimi i krimit dhe korupsionit.

Pikërisht kjo çfarë u tha, as Kuvendi e as Qeveria nuk mund të jenë të pafajshme, fillimisht gjatë propozimit, zgjedhjes dhe emërimit të njerëzve në krye të këtryre institucioneve. Mos të harrojmë edhe mundësinë e Vetëingut, sepse siç po flitet këtu nuk kemi ne mekanizma me mbikqyrë tash veprimet e gjyqtarëve dhe prokurorëve, por egzistojnë mekanizmat të cilat dëshmojnë dhe japin prova rreth kredibilitetit, sepse për me gjykua jo drejt, një njeri fillimisht duhet mos të jetë në rregull diçka me të dhe në raport me drejtësinë nuk është vetë në rregull, sepse për krejt që u fol këtu, mbatja me vite e lëndëve, grumbullimi i lëndëve mos zgjidhja e tyre, si edhe pritja në paraburgim 4 vite, për këto dikush duhet me dhënë përgjegjësi.

Çështja tjetër te zbatimi i ligjeve, është që shumë akte nënligjore e vonojnë zbatimin e legjislacionit, prandaj besoj që e keni prioritet edhe nxjerjen e këtyre akteve, sepse dihet që në pjesë më të madhe e bëjnë ligjin të pamundur për me u zbatuar.

Problem tjetër është po ashtu parashkrimi i lëndëve, kjo po ndodh kryesisht me njerëz të afërt me politikën dhe ky është problem i madhë ne shoqëri dhe mos të na quajnë shtet i parashkrimit të lëndëve. Mendoj që në instancë të fundit çëllimi i asaj është që ta kemi një shtet të së drejtës dhe shtet ligjor, unë mendoj që gjithmonë do të jemi nën llupë të bashkësisë ndërkombëtare se a po arrijmë t'i afrohem shtetit ligjor. Po ashtu mendoj që kemi pa probleme me viktimat e dhunës seksuale jo vetëm gjatë luftës, por siç po shihen janë shumë prezente edhe në periudhën e pas luftës. Prandaj, ne si grup për rekomandime për rastin e Drenasit, jemi marrë shumë edhe me një problematikë që nuk kemi gjyqtar dhe prokuror të trajnuar apo profesionalizuar që t'i trajtojmë me prioritet këto raste po edhe të jenë njohës të çështjeve. Komisioni për të drejtat e njeriut

më ka informua që i kanë dhënë disa rekomandime në këtë drejtim, që këto lëndë të kenë prioritet në trajtim dhe të kenë gjyqtar dhe prokuror të cilët enkas do t'i trajtojnë. Mund të them se në rastin e Drenasit ka pas dështim në gjitha instancat, prandaj besoj që në këtë drejtim është mirë që edhe këtë segment ta trajtoni shumë me kujdes, sepse vërtetë këto viktime janë shumë të stigmatizuara e kanë të vështirë t'i drejtohen organeve të drejtësisë, e kanë të vështirë t'i ruhet konfidenca dhe për me ju mundësu viktimave që t'i denocojn këto raste ne duhet ta kemi një besueshmëri në organet e drejtësisë ku ju drejtohen. Sfida kryesore e juaj ministër mbetet luftimi i krimit në nivele të larta dhe të jepni prova që vërtet gjykohen dhe denoncohen fillimisht rastet e profilit të lartë.

Kryetarja: tha se pajtohet me parafolësen që është obligim institucional që të punojmë për një çasje më të lehtë në drejtësi të viktimave seksuale dhe ta adresoni këtë çështje.

Ministri: Për ta treguar të kundërtën, atë që e thatë ju me çdo respekt për juve, mirëpo është angazhim konkret i ministrisë, e jo fasad në përmbushjen e obligimeve.

Sa i përket çështjes së sinjalizuesve e theksova gjatë prezentimit tim se e kemi një prej ligjeve më të mira që i kemi në rajon, ne do ta fillojmë së bashku një fushat me Agjencinë për Anti korrupsion, kemi plan konkret që ta sensibilizojm dhe ta bëjmë të çart për secilin institucion se cili është roli i sinjalizuesit, cilat janë obligimet tona si institucione për implementimin e këtij ligji. Sa i përket çështjes së noterëve dhe përmbaruesëve mendoj se në përgjithësi ka qenë një storie e suksesit në Republikën e Kosovës. Ne aktualisht i kemi 72 noter në Republikën e Kosovës. Jemi në përfundim të udhëzimeve administrative dhe akteve nën ligjore dhe besoj nga fillimi i muajit të ardhshëm do të fillojmë rekrutimin e noterëve të rinj. Nuk synojm tash mbi popullimin e noterëve se nuk duhet ta destabilizojm sistemin të cilin e kemi krijuar duhet të jemi shumë të kujdesshëm.

Kemi 42 përmbarues privat në Republikën e Kosovës dhe deri sot prej themelimit të këtyre institucioneve janë marrë më shumë se 90 masa diciplonore ndaj këtyre përmbaruesve.

Me rregulloren e re të MD e kam paraparë edhe themelimin e një zyreje e cila merret me mbikqyrjen e punës së përmbaruesve privat. Çështja e ndërmjetësimit po ashtu është një çështje mjaft e rëndësishme që me ligjin e ri që e kemi miratuar vitin e kaluar kemi bërë një përparim të dukshëm dhe kjo do ndikoj në zbutjen e lëndëve që shkojnë drejtë gjykatave tona. Ne problemin kryesor me gjykata e kemi me gjykatën themelore të Prishtinës, jo për mos efikasitetin e tyre, por për shkak të mos përmbushjes së kapaciteteve të miftueshme duke pas parasysh organogramin që e ka kjo gjykatë dhe dallimin që e bën me gjykatat tjera.

Sa i përket çështjes, raportit politikë- drejtësi, e shoh që, mos të them që këto 20 vite liri, kemi dështuar në ndërtimin e një raporti të mirëfilltë si institucione, pra si politikë me institucionet gjyqësore, kemi çaluar shumë! Pse po e them këtë? Po e përmendi edhe një fakt që nga ky po dal edhe po e elaboroj. Më 1 janar të vitit 2017 Republika e Kosovës i ka pasur 320 gjyqtarë, sot Republika e Kosovës i ka 430 gjyqtarë dhe jemi në rekrutim e sipër të 27 gjyqtarëve tjerë. Pra i bie që gjysma e gjyqtarëve në Republikën e Kosovës, janë me përvojë më pak se 5 vjet. Mendoj që kjo është e dëmshme, si politik nuk e kemi përcjellë gjyqësorin me hapa të duhur për mos lejimin e krijimit të kësaj gjendje dhe tash ta mbi popullojmë me gjyqtarë të rinj dhe mendoj që këtu kemi dështuar dhe që nuk i bën mirë as sistemit. Prandaj po them edhe sot si ministër kritikohem për raportet e mia me Këshill Gjyqësor dhe Prokurorial. Pra, të gjitha këto

të arritura për to i kam bërë si një bashkëpunim i rregullt duke i adresu mungesat që i kemi në sistem.

Këto Institucione janë kategori kushtetuese dhe pavarësia e tyre buron nga Kushtetuta, por mos të harojmë se pavarësia financiare varet nga Kuvendi i Kosovës. Por ne kemi dështuar 10 vitet e fundit me pas një komunikim të mirëfilltë, me Këshillin Gjyqësor dhe Këshillin Prokurorial për me muajt me arritur efikasitetin dhe mos me pasur këto mbi popullime me gjyqtarë tash. Mos ta cenojmë pavarësinë e tyre financiare sepse kjo rrjedhimisht ka me caktuar ngecjen dhe problemet e mëdha që i ceku deputeti Visari, pra këto probleme neve po na shkaktojnë pastaj një zingjir të problemeve tjera qysh janë vendimet e tyre ku ndoshta një person që ka grabit me armë dënohet 7 vjet dhe një person tjetër që i mbyt dy këmbësorë me veturë dënohet 3 vjet, mirëpo këto i kemi kur e ke një sistem, një gjyqtar që më shumë se gjysma e tyre janë me më pak se 5 vjet përvojë.

Sot kur e shohim Ministrin e Drejtësisë në këto takime në këto institucione, e shohim si një lloj ndërhyrje në drejtësi, pra duhet ta kemi të qartë, këto janë Institucione që administrojnë me gjykata dhe me prokurori nuk po flas me gjyqtarë dhe prokurorë të cilët shkojnë dhe shqiptojnë masa dënime, sepse nuk është çështje e Ministrisë së Drejtësisë, ajo është çështje e pavarësisë së tyre, ne po flasim sepse në fund të fundit ato e kanë një vartësi nga Parlamentit, pra siç është çështja e financave ndaj këtyre Institucioneve. Unë mendoj që jam duke u munduar me e vu një komunikim me këto dy institucione që mos me i pas probelemet të cilat i kemi pasur në të kaluarën, sepse në fund të fundit kanë me qenë qytetarët ata të cilët kanë me u ballafaquar megjithatë me mos përvojën e tyre, pa aftësinë e gjitha me radhë.

Pikërisht çështjen e komunikimit, çështjen e sigurisë juridike të qytetarëve, çështjen e komunikimit tonë që të garantojmë një siguri juridike për qytetarët jemi duke e adresuar me ri shikimin funksional, është një reformë e thellë për të cilin kam angazhu ekspertizë të huaj sepse e kemi të pa mundur ta kryejmë vetë ,kam 4 projekte të angazhuara: 2 nga Bashkimi Evropian, 1 nga Mbretëria e Bashkuar dhe një nga USAID-i, që të na ndihmojnë në këtë aspekt me ekspertizë sepse e kemi të pamundur ta bëjmë vetë.

Sepse nuk është problemi që e kemi sot e 2 vite, mirëpo është akumuluar tash e 20 vite si rezultat i një mos komunikimi të duhur dhe një raporti që do të duhej të kishim si Institucione politike me Këshill Gjyqësor dhe me Këshill Prokurorial. Siguria juridike për qytetarë është tejet e rëndësishme, edhe çështja e konfiskimit është një shqetësim i imi është një shqetësim i politikës dhe çdo qytetari, sepse siç e thatë edhe ju prapë ajo pasuri e sekuestruar për një periudhë të caktuar prapë ju kthye atyre bandave krinimanale, trafikëve të drogës, njerëzve të akuzuar për korrupsion e kështu me radhë. Ne do të fillojm tani trajnimin e gjyqtarëve, të hetuesve dhe prokurorëve për masat e reja se nuk është e mjaftueshme ky ligj të jetë në sirtar dhe të themi tash kemi masa të reja për siguri nëse ne nuk kemi hetues të trajnuar, të pregaditur mirë konform këtyre masave, pra është një ndërmarrje jashtëzakonisht e madhe e Ministrisë së Drejtësisë, mund të kemi çalime gjatë kësaj periudhe, por janë 3 agjenda që ecim ne paralelisht; rishikimi funksional, që janë të angazhuar mbi 50 ekspertë nga Këshili Gjyqësor, Këshilli Prokurorial, ekspertë nga projektet që i përmenda edhe Ministria e Drejtësisë, është drejtësia 2020, një komunikim i ri i ministrisë dhe ne për herë të parë e kemi marrë liderhipin e drejtimit të këtyre agjendave sepse deri tash e kemi pasur një kordinim të organeve që janë në sektorin e sundimit të ligjit që janë të udhëhequra nga EULEX-i.

Tashmë e kemi mekanizmin që i ka 100 masa konkrete që dalin me ligjet që i kemi në Kuvend dhe me masat e reja që mendojmë që ta marrim liderhipin si institucione në

adresimin e problemeve dhe këtyre të metave që i kemi në sistemin tonë gjyqësor dhe prokurorial. Parashkrimi i lëndëve po ashtu ka qenë një problem shumë i madh dhe e kemi ballafaquar në vazhdimësi janë rritur afatet e parashtrimit të lëndëve me kodin penal që me 15 prill do të hyjë në fuqi dhe ne tash veç se i kemi marrë masat me i njoftuar gjytarët dhe prokurorët me masat e reja që do të janë në fuqi nga 15 prilli.

Javën tjetër do të fillojmë së bashku edhe me BE- në trajnimin e gjyqëtarëve dhe prokurorëve sa i përket dhunës në familje dhe padyshim sepse vërtet kanë qenë tmerruese ballafaqimet e tona të fundit që jemi ballafaquar si shoqëri.

Ismajl Kurteshi: Gjatë këtij takimi u konstatua se në sistemin e drejtësisë ka të meta të mëdha të cilat shpesh herë janë si akte subjektive të atyre që janë në këtë sistem, a konsideroni që ky sistem ka nevojë për të filluar procesin e Vetingut i cili sigurisht do të ndihmonte që ky sistem të korrigjohet dhe të bëhet më efikas dhe rastet që u përmendën të dy grave viktima në komunikacion, të dënimeve qesharake, a mendoni se mund të të arsyetohen me mungesën e përvojës pasi që edhe qytetarët e thjeshtë kanë reaguar që absolutisht nuk janë jurist, apo është keq përdorim i pozitës?

Armend Zemaj: Më intereson ku ka arritur Kodi civil, sepse e përfshin edhe një fushë të madhe që ka të bëjë me të drejtat në familje, të grave në përgjithësi po edhe në trashëgimi, për të gjitha këto besoj që e keni një përgjigje, edhe e dyta te rishikimi funksional, e plotësoj kolegu im Ismajli, po më intereson a përshihet edhe Vetingu në rishikimin funksional? Ndërsa për sqarim atë pjesën që e ndërlidha ajo që thashë, ajo nuk ishte direkt për sqarim sa i përket Minisrisë së Drejtësisë dhe ju pjesa e fasadimit, por kjo është e njëjtë, gjithë kjo punë sikur që tash po bëhet ose që është proklamuar në të kaluarën, nëse nuk ka impakt kjo vetëm mbulohet dhe përcjellët me një mbulesë tjetër, por unë po flas për rezultatet. Shifrat reale janë rezultate të implementimit të ligjit edhe po besoj që unë i përmenda edhe deklaratimet e juaja publike edhe ato çka i thatë këtu, që është një diçka e mirë që mënyra kur vihen në sipërfaqe problemet edhe nuk tentohet të fshihet atëherë besoj se zgjidhen më shpejt, sidomos raste të rënda që kanë të bëjnë me krimin e organizuar dhe korrupsionin. Unë insisto që të takoheni më shpesh me Këshillin Gjyqësor dhe Këshillin Prokurorial, dhe njëfarë forme ky relacion të shëndrohet në relacion ditor të përcjelljes efektive sidomos të performances së sistemit të drejtësisë në vend. Me vullnet nuk shkojnë këto gjëra, por duhet një mbikëqyrje më rigorozë dhe me masa adekuarte.

Ministri: lidhur me Vetingun tha se kam kërkuar një ekspertizë nga ndërkombëtarët dhe Ambasada Britanike ka angazhuar disa ekspertë për të na ndihmuar, jemi duke parë mundësinë që në kuadër të rishikimit funksional, cili do të jetë mekanizmi që ne do ta krijojmë dhe në fund të krijohet në Kuvend institucioni të pa varur për verifikimin e gjyqëtarve dhe prokurorëve në periudha permanente.

Sa i përket çështjes së Kodit civil mendoj që jemi në përfundim të draftit të parë me përkrahje nga Zyra e BE-së në Kosovë dhe në Kuvend do ta përcjellim në qershor dhe pres përkrahjen maksimale nga ju. Pajtohem që na duhet një komunikim më i madh me Këshillin Gjyqësor dhe prokurorial, ne kemi obligim që edhe ata t'i bëjmë përgjegjës për mos punën dhe dështimet e tyre.

Kryetarja: falenderoj ministrin për raportimin e detajuar, në mungesë kuorumi nuk vazhdoj me pikat tjera dhe e mbylli mbledhjen.

Mbledhja përfundoi në orën 11:46.

Përgatitur nga
Njësia për mbështetjen e komisionit

Kryetare e komisionit,

Blerta Deliu-Kodra
